



UDHËZIM

PËR ZBATIMIN E NJË KORNIZË TË PËRBASHKËT PËR STATISTIKAT EVROPIANE NË LIDHJE ME PERSONAT DHE NJËSITË EKONOMIKE FAMILJARE, BAZUAR NË TË DHËNAT NË NIVEL INDIVIDUAL, TË MBLEDHURA NGA KAMPIONI¹

Nr. 1, datë 27.12.2024

Bazuar në ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026, nenet 17/4 dhe 20/b të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, VKM nr. 16, datë 11.01.2024 “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024- 2026” (PKIE 2024-2026) me qëllim krijimin e kuadrit rregullator për zhvillimin e vrojtimeve statistikore sociale

U D H Ë Z O J:

1. Vrojtimet statistikore sociale të kryhen në përputhje me përcaktimet e Aneksit 1, Aneksit 2, Aneksit 3, Aneksit 4 dhe Aneksit 5 të këtij Udhëzimi.
2. Planifikimi dhe zbatimi i Aneksit 1, Aneksit 2, Aneksit 3, Aneksit 4 dhe Aneksit 5 të këtij Udhëzimi të pasqyrohet në Planin Vjetor përkatës për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, me synim rritjen e nivelit të përputhshmërisë me kërkesat e Rregullores (EU) 2019/1700 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të 10 Tetor 2019.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor për zbatimin e këtij Udhëzimi.
4. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elsa Dhuli



¹¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me: Rregulloren (EU) 2019/1700 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të 10 Tetor 2019, që vendos një kornizë të përbashkët për statistikat evropiane në lidhje me personat dhe njësitë ekonomike familjare, bazuar në të dhënat në nivel individual, të mbledhura nga kampioni.